

Ikona “Pagëzimi i Krishtit”-periudha Post-Bizantine



Ikona është pjesë e fondit të MKAM në Korçë. Ajo paraqet një prej skenave kryesore në jetën e Krishtit. Skena zhvillohet në lumin Jordan aty ku Johan Pagëzori realizoi pagëzimin e Krishtit.

Ikona është pikturuar në mënyrë realiste ndërmjet një peisazhi të bukur natyror. Në pjesën e sipërme ndërmjet reve në qiellin blu është pikturuar Ati i Shenjtë i cili sosit skenën nga lart.

Pjesa qendrore përmban personazhet kryesore të skenës pikërisht Johan Pagëzorin duke hedhur ujin e lumit mbi kryet e Krishtit si dhe vetë Krishtin i cili në pozicion lutjeje pranon mbretërinë e qiellit. Përkrah tij shfaqen dy engjëj të cilët jo vetëm ndjekin me vëmendje skenën e pagëzimit por mbajnë në duar dhe rrobat e Krishtit.



Ἡ Βάντις τοῦ
Ἰησοῦ Χριστοῦ.

— facebook.com/MuzeuiArtitMesjetar